



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA		
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO		
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL		
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA		
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT		
Arkivi Qendror - Centralno Arhivo - Central Archive		
Nr./Br./No.	4407	
Nr. i fq./Br. Str./No. pg.	6+6+6	
Data/Datum/Date:	25.11.2024	
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA		

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**Qeveria – Vlada – Government**

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**  
**Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja – Ministry of Agriculture,**  
**Forestry and Rural Development**

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR) - NR. 09/2024<sup>1</sup>**  
**PËR ORGANIZIMIN DHE MENAXHIMIN E RRJETIT TË TË**  
**DHËNAVE TË KONTABILITETIT NË FERMË**

<sup>1</sup>Udhëzim Administrativ (MBPZHR) - NR. 09/2024 Për Organizimin dhe menaxhimin e rrjetit të të dhënave të kontabilitetit në fermë i nënshkruar nga Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me datë 28.10.2024.

## **Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,**

Në mbështetje të nenit 38, paragrafi 4 dhe 5, të Ligjit Nr. 08/L-072 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 8/29 Mars 2023), duke u bazuar në nenin nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.34/18 Nëntor 2022), , si dhe nenin 9 paragrafi 2, të Rregullores (QRK) – Nr.17/2024 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (publikuar në Gazetën Zyrtare - me datë 21.06.2024), Nxjerrë:

### **UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR) - NR. 09/2024 PËR ORGANIZIMIN DHE MENAXHIMIN E RRJETIT TË TË DHËNAVE TË KONTABILITETIT NË FERMË**

#### **KAPITULLI I**

#### **DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1 Qëllimi**

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohet mënyra e organizimit dhe menaxhimit të Rrjetit të të dhënave të kontabilitetit në fermë duke përfshirë procesin e mbledhjes së të dhënave për strukturën fizike dhe gjendjen financiare të ekonomive bujqësore për vitin kalendarik për të cilin mbledhen të dhënat në përputhje me praktikën e Bashkimit Evropian si dhe përpunimin e të dhënave, përcaktimin e të ardhurave vjetore të ekonomive bujqësore dhe matjen e efikasitetit dhe efektivitetit të ekonomive bujqësore.

##### **Neni 2 Fushëveprimi**

Dispozitat e këtij udhëzimi administrativ janë të detyrueshme për Ministrinë përgjegjëse për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural - Departamentin përkatës për Analiza Ekonomike dhe Statistika Bujqësore si dhe të gjithë personat fizik dhe juridik që bëjnë mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave të kontabilitetit në fermë.

##### **Neni 3 Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë këto kuptime:

**1.1. “RrDhKF”** – nënkupton Rrjeti i të dhënave të kontabilitetit në fermë;

**1.2. “Ministër”** – nënkupton Ministri i ministrisë përgjegjëse për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural;

**1.3. “Ministria”** – nënkupton Ministrinë përgjegjëse për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural;

**1.4. “Njësia përgjegjëse”** - nënkupton Departamentin përkatës për Analiza Ekonomike dhe Statistika Bujqësore;

**1.5. “Mostra”** - nënkupton madhësinë e mostrës përfaqësuese e cila përcaktohet me metoda statistikore;

**1.6. “Outputi standard”** – nënkupton vlerën mesatare monetare të prodhimeve bujqësore të llogaritur me çmime në nivel të fermës duke përfshirë çfarëdo ndihme apo takse;

**1.7. “DAESB”** – nënkupton Departamentin përkatës për Analiza Ekonomike dhe Statistika Bujqësore;

**1.8. “DPZhR”** – nënkupton Departamentin përkatës për Politikat e Zhvillimit Rural;

**1.9. “DShKT”** – nënkupton Departamentin përkatës për Shërbime Këshillimore dhe Teknike;

**1.10. “Këshilli”** – nënkupton Këshillin për RrDhKF;

**1.11. “Madhësi ekonomike”** – nënkupton madhësinë ekonomike të ekonomive bujqësore të përcaktuar në bazë të llogaritjes së vlerës së outputit standard;

**1.12. “Lloji i fermës”** – nënkupton llojin e fermës/ekonomisë bujqësore të përcaktuar në bazë të llogaritjes së pjesëmarrjes së vlerës së outputit standard sipas sektorëve në gjithë vlerën e outputit standard të ekonomisë bujqësore;

**1.13. “Njësi vjetore e punës”** – nënkupton njësi matëse të punës që llogaritet duke pjesëtuar numrin e orëve të punuara në vit me numrin vjetor të orëve që korrespondojnë me punën me kohë të plotë.

2. Shprehjet e tjera të përdorura në këtë udhëzim administrativ e kanë kuptimin e njëjtë sikurse që janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 08/L-072 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 8/29 Mars 2023).

#### **Neni 4**

##### **Përfshirja e ekonomive bujqësore në RrDhKF**

1. Fusha e shtrirjes së anketës së RrDhKF mbulon vetëm fermat, madhësia e të cilave tejkalon një prag minimal të matur si vlerë totale standarde e prodhimit të fermës, e shprehur në euro në momentin e llogaritjes së outputit standard dhe klasifikimit të fermave.

2. Ekonomitë bujqësore të përfshira në fushën e observimit të RrDhKF përfaqësojnë përqindjen më të madhe të mundshme (mbi 80%) të gjithë vlerës së prodhimit bujqësor, sipërfaqes bujqësore, njërive blegtorale dhe njërive vjetore të punës.

#### **Neni 5**

##### **Njësia përgjegjëse**

1. Njësia Përgjegjëse është njësi zbatuese në nivel vendi dhe detyrat e saj janë si vijon:

1.1 Kryen detyra që kanë të bëjnë me menaxhimin administrativ dhe organizimin e aktiviteteve për zhvillimin e RrDhKF, mirëmban dhe menaxhon përdorimin e bazës së të dhënave.

1.2. Siguron që të gjitha strukturat organizative dhe institucionet përfshirë edhe ato jashtë Ministrisë të përmbushin përgjegjësitë dhe detyrat e tyre duke siguruar komunikim dhe koordinim ndërmjet të gjitha palëve të përfshira në procesin e realizimit të RrDhKF.

1.3. Komunikon me Komisionin Evropian dhe Këshillin për RrDhKF, për të përcjellë zhvillimet në lidhje me RrDhKF dhe siguron zbatimin e tyre në praktikë.

1.4. Siguron bashkëpunim dhe koordinim në përgatitjen e planit të përzgjedhjes së ekonomive bujqësore.

1.5. Paraqet para Këshillit për RrDhKF planin për përzgjedhjen e ekonomive bujqësore për vitin aktual dhe raportin e zbatimit të planit të përzgjedhjes së ekonomive bujqësore nga viti paraprak.

1.6. Përgatit listën me kriteret dhe kufijtë e testimit në mënyrë që të sigurojë të dhëna cilësore, të besueshme dhe në bazë të kriterëve bën korrigjimin dhe përditësimin e të dhënave në bashkëpunim me personat fizik apo juridik të angazhuar për mbledhjen e të dhënave.

1.7. Siguron përdorimin e të dhënave duke ruajtur konfidencialitetin e ekonomive bujqësore që janë pjesë e mostrës.

## **Neni 6** **Këshilli për RrDhKF**

1. Këshilli për RrDhKF është organ vlerësues dhe këshillues i formuar me vendim nga ana e Ministrisë dhe detyrat e tij janë si vijon:

1.1. Miratimi i planit për përzgjedhjen e ekonomive bujqësore, duke specifikuar shpërndarjen e ekonomive bujqësore për tu përfshirë në RrDhKF në bazë të llojit të prodhimit dhe madhësisë ekonomike.

1.2. Miratimi i raportit lidhur me zbatimin e planit për përzgjedhjen e ekonomive bujqësore për vitin paraprak.

1.3. Të bëjë rekomandime për përdorimin e të dhënave të mbledhura, për të shtuar të dhëna në pyetësor dhe për të siguruar qëndrueshmërinë e tij.

1.4. Këshilli për RrDhKF përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve si në vijim:

1.4.1. Kryesuesi që është udhëheqësi i DAESB-së;

1.4.2. Tre (3) anëtar: një (1) DAESB, një (1) DPZhr dhe një (1) DShKT;

1.4.3. Një (1) anëtar nga Agjencia përgjegjëse e Statistikave të Kosovës;

1.4.4. Një (1) anëtar nga Agjencia përgjegjëse për Zhvillimin e Bujqësisë;

1.4.5. Një (1) anëtar nga Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Bujqësisë.

1.5. Anëtarët e Këshillit për RrDhKF propozohen nga institucionet përkatëse për një periudhë tre (3) vjeçare me mundësi vazhdimi.

1.6. Mbledhjet e Këshillit për RrDhKF udhëhiqen nga udhëheqësi i njësisë përgjegjëse.

1.7. Udhëheqësi i Këshillit për RrDhKF mund të ftojë ekspertë të tjerë për të marrë pjesë në punën e Këshillit varësisht nevojave specifike.

1.8. Udhëheqësi i Këshillit për RrDhKF për çdo takim të Këshillit harton procesverbal lidhur me punën e Këshillit dhe aprovimet e rekomandimet që dalin.

1.9. Këshilli për RrDhKF mblidhet të paktën një herë në vit por në rast nevojë mund të takohen edhe më shpesh me ftesë paraprake nga udhëheqësi i Këshillit.

#### **Neni 7**

#### **Përzgjedhja e ekonomive bujqësore**

1. Ekonomitë bujqësore në mostrën e RrDhKF duhet të përzgjidhen bazuar në planin e përzgjedhjes për të siguruar të dhëna representative/përfaqësuese në dy dimensione: madhësi ekonomike dhe lloj të fermës, e të cilat përcaktohen në bazë të gjithsej vlerës së outputit standard dhe vlerës së outputit standard sipas sektorëve për ekonomitë bujqësor.
2. Fusha e anketimit në RrDhKF bazohet në popullacionin e ekonomive bujqësore që menaxhohet nga Agjencia përgjegjëse e Statistikave të Kosovës.
3. Plani i përzgjedhjes hartohet mbi bazën e të dhënave statistikore më të fundit nga Regjistrimi i Bujqësisë ose nga Anketa e Strukturës së Fermave të kryera ndërmjet regjistrimeve, burimeve administrative ose burimeve të tjera të besueshme.
4. Pjesëmarrja e fermave në RrDhKF është në baza vullnetare.
5. Mostra e fermave duhet të jetë representative/përfaqësuese.

#### **Neni 8**

#### **Mbledhja, përpunimi dhe publikimi i të dhënave**

1. Mbledhja e të dhënave bëhet duke u bazuar në mostrën e përcaktuar nga Njësia përgjegjëse.
2. Mbledhja e të dhënave mund të bëhet nga persona fizik apo juridik, publik apo privat.
3. Mbledhja e të dhënave bëhet në bazë të pyetësorit i cili hartohet nga Njësia përgjegjëse.
4. Përpunimi i të dhënave bëhet nga njësia përgjegjëse në bashkëpunim me personat fizik apo juridik.
5. Publikimi i të dhënave bëhet nga Njësia përgjegjëse.
6. Të dhënat duhet të publikohen vetëm si të grupuara.
7. Minimum duhet të jenë 5 ekonomi bujqësore në një madhësi ekonomike apo tip të fermës që të dhënat të publikohen dhe nëse në një grup janë më pak se 5 ferma atëherë duhet të bëhet bashkimi i grupeve.

#### **Neni 9**

#### **Privatësia dhe siguria e të dhënave konfidenciale**

1. Të dhënat individuale të mbledhura përmes anketës së RrDhKF mund të përdoren vetëm në përputhje me Ligjin përkatës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
2. Njësia përgjegjëse duhet të garantoj konfidencialitetin dhe sigurinë e të dhënave personale dhe konfidenciale.

**Neni 10**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.



Faton PEÇI

Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë, dhe Zhvillimit Rural

Datë: 02 / 11 2024